



Republika e Maqedonisë së Veriut



AGJENCIA E MBROJTJES TË SË  
DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË  
INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK



*i*



# DORACAK PËR ZBATIMIN E TESTIT TË DËMIT





Republika e Maqedonisë së Veriut



AGJENCIA E MBROJTJES TË SË  
DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË  
INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK



# DORACAK PËR ZBATIMIN E TESTIT TË DËMIT

**PROJEKTI: PROMOVIMI I TRANSPARENCËS DHE PËRGJEGJËSISË NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

**DORACAK PËR ZBATIMIN E TESTIT TË DËMIT**

**KORDINUES I KOMPENTIT 2 TË PROJEKTIT:**

Aleksandar Kashumov, Bullgari

**PËR AGJENCINË PËR MBROJTJEN E TË DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK:**

Aleksandra Stojanovska, menaxher projektues

Gorjan Gilevski, asistent projektues dhe koautor i tekstit

Të punësuarit nga Sektori për punë juridike dhe të përgjithshme pranë Agjencisë dhe z-nja Pllamenka Bojçeva, Drejtoreshë e Agjencisë

---

*Ky dokument është përparitur në kuadër të projektit “Promovimi i transparencës dhe përgjegjësisë në administratën publike”, financuar nga ana e Bashkimit evropian, ndërsa implementuar nga ana e konzorciumit të udhëhequr nga PwC. Dokumenti është përparitur për nevojat e Agjencisë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik dhe vetëm për qëllimet dhe sipas kushteve të kontratuara në pajtueshmëri me EuropeAid/139891/DH/SER/MK.*

*Udhëzimet, konkluzat dhe interpretimet e shprehura në këtë document në asnjë rast nuk duhet të llogaritet se i pasqyrojnë politikat apo mendimet e Bashkimit evropian.*

*PwC nuk ndërmer asnjë përgjegjësi (kyçur edhe pakujdesinë) ndaj personave të tretë në lidhje me këtë document.*

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE</b> .....	<b>5</b>
<b>2. KUSH E ZBATON TESTIN E DËMIT</b> .....	<b>6</b>
<b>3. UDHËZIME DHE HAPA PËR ZBATIMIN E TESTIT</b> .....	<b>6</b>
<b>4. PËRKUFIZIME NË PAJTUESHMËRI ME LIGJIN</b> .....	<b>8</b>
4.1. Përkufizime të përcaktuara me LQLIKP .....	8
4.2. Dispozita tjera adekuate për përjashtimet .....	8
<b>5. INTERESE TË MBROJTURA</b> .....	<b>9</b>
<b>6. PËRCAKTIMI I INTERESIT TË MBROJTUR</b> .....	<b>10</b>
6.1. Informacione të klasifikuara .....	11
6.2. Të dhëna personale .....	12
6.3. Informacione lidhur me besueshmërinë e procedurave tatimore .....	12
6.4. Informacione të fituara apo të përpiluara për hetim, procedurë penale apo për kundërvajtje .....	12
6.5. Informacioni i marrë ose i përpiluar për zhvillimin e një procedure administrative .....	13
6.6. Informacioni i marrë ose i përpiluar për zbatimin e procedurave qytetare .....	14
6.7. Informacioni i cili i rrezikon të drejtat e pronësisë intelektuale .....	14
<b>7. KUR PËRCAKTOHET DËMI?</b> .....	<b>15</b>
7.1. Vlerësimi i cili bëhet para se të dorëzohet kërkesa .....	15
7.2. Vlerësimi i cili bëhet pasi të dorëzohet kërkesa .....	15
<b>8. KOHËZGJATJA E MBROJTJES SË INFORMACIONEVE</b> .....	<b>16</b>
8.1. Përcaktimi i periudhës së mbrojtjes .....	16
<b>9. PROPORCIONALITETI NË ZBATIMIN E PËRJASHTIMEVE</b> .....	<b>17</b>
9.1. Interpretim i ngushtë i përjashtimeve .....	18
9.2. Përcaktimi i formës së qasjes .....	18
9.3. Mundësimi i qasjes së pjesërishtme .....	18
<b>10. BALANCIMI I DËMIT KUNDREJT INTERESIT PUBLIK NGA PUBLIKIMI I INFORMACIONIT</b> .....	<b>19</b>
10.1. Interes publik mbizotërues për publikimin e informacionit .....	19
10.2. Rrethanat e interesit publik .....	20
10.3. Qëllimet e publikimit me interes publik .....	20

**11. VENDIM PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK ..... 20**

**SHEMBULL ..... 22**

**Hapi 1:** A ekziston përjashtim relevant? ..... 22

**Hapi 2:** A ekziston interes i mbrojtur? ..... 22

**Hapi 3:** A ka dëm nga publikimi? ..... 22

**Hapi 4:** A ekziston interes publik më i madh? ..... 22

**Hapi 5:** Proporcionaliteti ..... 23

**Hapi 6:** Sjellja e vendimit të jepet apo të rrefuzohet dhënia e informacionit ..... 23

**Hapi 7:** Sqarimi i vendimit ..... 23

## 1. HYRJE

E drjeta për qasje të lirë në informacione me karakter publik në shoqërinë bashkëkohore është një ndër të drejtat kyçe të qytetarëve. Kjo është e drejtë njerëzore e cila siguron transparencë dhe llogaridhënie të organeve publike, mundëson kontrollë publike mbi punën e tyre nëpërmjet parandalimit të korrupsionit dhe paligjshmërive tjera, paraqet mjet jashtëzakonisht të fuqishëm që kontribuon kah puna e hapur dhe përdorimi efikas i mjeteve publike dhe krijon bazë për qeverisje të mirë dhe besim të qytetarëve në punën e institucioneve.

Ligjet të cilat e rregullojnë të drejtën për qasje të lirë në informacione e vërtetojnë mënyrën e realizimit të kësaj të drejte, fillimisht nëpërmjet obligimit për publikim proaktiv të informacioneve të organeve publike, e pastaj nëpërmjet procedurës për kërkim të qasjes së lirë në informacione me karakter publik, si dhe mbikqyrje të respektimit të obligimeve ligjore nga ana e organeve publike.

Pjesë përbërëse e më shumë ligjeve të cilat e rregullojnë këtë të drejtë është a.q. **Testi i dëmit**, i cili në fakt është obligim dhe instrument për vlerësim se a mbizotëron interesi publik për qasje në informacione ndaj nevojës që të përkufizohet qasja në informacione për shkak të mbrojtjes së të drejtave të caktuara të përshkruara me ligj. Rrjedhimisht, nëse flasim për të drejtën e qasjes në informacione si e drejtë e garantuar me kushtetutë, e drejtë themelore e njeriut për qasje në informacione të cilat i posedojnë organet publike si dhe mjet parandalues antikorruptiv dhe mjet për mbizotërimin e të drejtës dhe përforcim i llogaridhënies së organeve publike, atëherë testi i dëmit është institut i tij fundamentalist.

E thënë thjesht, testi i dëmit është një vendim i shkallës dhe diskrecionit më të lartë, i marrë nga një organ publik kur vendos për një kërkesë për qasje të lirë në informacion publik, i cili përcakton nëse interesi publik mbizotëron për të mbajtur informacionin e kërkuar brenda fushës së kufizimit ose nëse interesi publik për informacionin e kërkuar do të mbizotërojë për t'u përjashtuar nga kufizimi ekzistues dhe i vihet në dispozicion kërkuarit, dhe me këtë edhe publikut të gjerë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, qasja e lirë në informacione të cilat i posedojnë organet publike është e garantuar me nenin 16 të Kushtetutës. Mënyra e realizimit të kësaj të drejte është e përcaktuar me Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik<sup>1</sup> në (në tekstin e mëtejshëm: **LQLIKP**) ku, mes tjerash, është përshkruar procedurë e posaçme për kërkesën e dorëzuar për qasje të lirë në informacione me karakter publik<sup>2</sup>, përjashtimet nga qasja e lirë<sup>3</sup> si dhe zbatimi i testit të dëmit<sup>4</sup>.

Në kuadër të praktikës së deritanishme së Agjencisë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik (në tekstin e mëtejshëm: **Agjencia**), organet publike – posedues të informacioneve nuk e zbatojnë testin e dëmit në mënyrë adekuate. Gjatë ballafaqimit me kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik që potencialisht është lëndë e një prej përjashtimeve të ligjit, praktika e poseduesve është e thjeshtë të mos e zbatojnë testin dhe ta injorojnë nenin 6 paragrafi 3 të LQLIKP ("informacioni është i mbrojtur, kërkesa rrefuzohet").

<sup>1</sup> („Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 101/19)

<sup>2</sup> Kreu IV i LQLIKP

<sup>3</sup> Shiko neni 6 paragrafi 1 të LQLIKP

<sup>4</sup> Shiko neni 6 paragrafi 1 të LQLIKP

Apo ta zbatojnë gabimisht (p.sh. pa hapat adekuate), pa i arsyetuar shkaqet për mënyrën në të cilën kërkesa është e procesuar.

Rrjedhimisht, ky Doracak ka për qëllim t'i japë përkrahje Funksonarit – gjegjësisht personit udhëheqës tek poseduesi i informacionit, si dhe personave zyrtar të autorizuar për ndërmjetësim me informacione me karakter publik – në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme ta zbatojnë testin e dëmit, dhe me këtë t'ju mundësojnë qytetarëve ta realizojnë të drejtën e tyre të garantuar me kushtetutë për qasje të lirë në informacione, në rastet kur nuk është e nevojshme që të përkufizohet qasja.

## 2. KUSH E ZBATON TESTIN E DËMIT

Person zyrtar për ndërmjetësim me informacione me karakter publik është person i cili kryesisht kujdeset për zbatimin e LQLIKP dhe e siguron zbatimin e tij tek poseduesi i informacioneve.

***Në pajtueshmëri me LQLIKP, procedurën pas kërkesës për qasje në informacione e zbaton personi zyrtar<sup>5</sup>.***

Megjithatë, duke patur parasysh se testi i dëmit është vendimi më i lartëtë cilin poseduesi i informacioneve mund ta sjellë gjatë vlerësimit se a është me interes publik që të lejohet apo përkufizohet qasja në informacionin e dhënë, rekomandim dhe praksë e mirë është që gjatë zbatimit të testit, përveç personit zyrtar të marrin pjesë edhe zyrtarë tjerë relevant apo të punësuar tek poseduesi i informacioneve<sup>6</sup>.

Në çdo rast, e posaçërisht kur bëhet fjalë për kërkesa më të komplikuar apo me vëllim më të madh për qasje të lirë, personi përgjegjës tek poseduesi i informacioneve është i obliguar të krijojë dhe të mbajë sistem komunikimi dhe përkrahje mes personave zyrtarë për ndërmjetësim me informacione me karakter publik dhe të punësuarit tjerë në institucion, me qëllim zbatimin e drejtë të procedurës së përgjithshme, kyçur me testin e dëmit.

## 3. UDHËZIME DHE HAPA PËR ZBATIMIN E TESTIT

Në parim, gjatë procedurës për kërkesë për qasje të lirë, poseduesi i informacioneve mund të rrefuzojë qasje në informacionin e kërkuar me karakter publik, me çka është i obliguar të bëjë vlerësimin e interesave, rrethanave dhe pasojave të cilat dalin nga apo janë në relacion me publikimin, gjegjësisht mos publikimin e informacionit të kërkuar.

Kjo mundësi e poseduesit është e përcaktuar në nenin 6 të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik, në pajtueshmëri me cilën qasje në informacion me karakter publik mund të rrefuzohet në raste të caktuara të theksuara taksative.

<sup>5</sup> Shiko neni 19 i LQLIKP

<sup>6</sup> Shiko neni 7 i Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 124/2015 dhe nr. 65/2018)



Për më tepër LQLIKP përcakton<sup>7</sup> që si përjashtim, edhe nëse informacioni bie nën një ose më shumë nga përjashtimet e përcaktuara ligjërisht, poseduesi i informacionit mund të sigurojë qasje në informacionin e kërkuar me karakter publik. Në atë rast, edhe nëse publikimi i informacionit të kërkuar shkakton "dëmtrim" të interesit të mbrojtur të poseduesit të informacionit, në kryerjen e testit të dëmshmërisë, interesi publik në publikimin e informacionit të kërkuar mund të tejkalojë interesin për mos publikimin e tij dhe si pasojë informacioni duhet të publikohet.

#### **KUJDES:**

**Megjithëse në një procedurë të veçantë me një kërkesë të paraqitur është identifikuar një bazë ligjore për mohimin e qasjes në informacionin e kërkuar, poseduesi nuk mund të mohojë automatikisht qasjen, por duhet të vlerësojë marrëdhënien midis dy interesave të mbrojtura - interesit për mbrojtje (mos publikimi) të informacionit të kërkuar dhe interesit për publikimin e informacionit.**

**Është me rëndësi të përmendet se edhe dy interesat e cituara janë legjitime dhe paraqesin aspekt të caktuar të interesit publik me vet faktin që të njejtat janë të rregulluara me Ligj dhe janë të njohura si legjitime.**

**Shpesh (edhe pse kryesisht) bëhet fjalë për dy të drejta të kundërta, ekuivalente, të garantuara me kushtetutë, siç janë e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale apo e drejta e pronësisë në krahasim me të drejtën për qasje në informacione apo vlera tjera të mbrojtura me Kushtetutë, siç është liria e të shprehurit. Prandaj qëllimi është që të vlerësohet se a tejkalon interesi publik për sigurimin e qasjes në informacionin demin potencial që do të kishte dalë nga publikimi i informacionit.**

Me qëllim zbatimit adekuat të nenit 6 të LQLIKP dhe nenit 13, paragrafi 3 nga Udhëzimi për mënyrën dhe procedurën për zbatimin e LQLIKP<sup>8</sup>, poseduesi i informacioneve është i obliguar t'i zbatojë hapat në vijim:

- 1) Përcaktimi i interesit të mbrojtur;
- 2) Përcaktimi i përjashtimit adekuat nga të theksuarat në nenin 6, paragrafi 1 të LQLIKP;
- 3) Kontrollim se a përshtaten dispozitat ligjore të nenin 6 të LQLIKP me interesin e mbrojtur të përcaktuar;
- 4) Kontrollim se a është e mundshme qasje e pjesërishtme apo ndryshim i mënyrës së njohjes me informacionin (parim i proporcionalitetit);
- 5) Kontrollim se a ka interes publik për publikim i cili mbizotëron në interesin për mbrojtje (mos publikim) të informacionit;
- 6) Sjellje të vendimit:
  - a. A të sigurohet qasje në të gjitha informacionet e kërkuara;
  - b. A të rrefuzohet qasje në të gjitha informacionet e kërkuara;
  - c. A të rrefuzohet qasje në pjesë të informacioneve të kërkuara.

<sup>7</sup> Shiko neni 6 paragrafi 3 i LQLIKP

<sup>8</sup> („Gazeta zyrtare e RMV” nr. 60/2020)

Pasi të zbatohen gjatë hapat e lartëpërmendura, personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione duhet të zbatojë edhe një hap i cili është shumë i rëndësishëm:

- 7) Të japë arsyetim të shkruar në aktin juridik (me të cilin proceduon për kërkesën) se si janë zbatuar gjashtë hapat e lartëpërmendura në krahasim me faktet konkrete relevante.

#### **KUJDES:**

**LQLIKP nuk e parashikon formën e testit të dëmit, i njejtë zbatohet në mënyrë proporcionale për secilën kërkesë posaçërisht, varësisht nga informacioni i kërkuar, konteksti i tij dhe rrethanat të cilat dalin nga publikimi i tij, gjegjësisht mos publikimi. Në mënyrë plotësuese, për një lloj të caktuar të informacioneve, dëmi është i përcaktuar paraprakisht, në pajtueshmëri me dispozitat të posaçme ligjore.<sup>9</sup>**

## **4. PËRKUFIZIME NË PAJTUESHMËRI ME LIGJIN**

Përkufizime për qasje në informacione mund të përcaktohen vetëm me Ligj. Kjo del nga fakti se në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e drejta për qasje në informacione me karakter publik fillimisht është nivel i garantuar me kushtetutë.<sup>10</sup> Gjithashtu, dispozitat adekuate nga LQLIKP i përcaktojnë përjashtimet e këtij ligji.

### **4.1. Përkufizime të përcaktuara me LQLIKP**

Në nenin 6 paragrafi 1 të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 2019 janë përcaktuar përkufizimet adekuate (përjashtime) të drejtës për qasje në informacione. Ato janë:

- 1) Informacion i cili në bazë të ligjit paraqet informacion të klasifikuar me shkallë adekuate të klasifikimit;
- 2) E dhënë personale zbulimi i së cilës do të ishte shkelja e të dhënave personale;
- 3) Informacion dhënia e së cilit do të ishte shkelje e besueshmërisë së procedurës tatimore;
- 4) Informacion i marur apo i përbërë për hetim, procedurë ndëshkuese apo kundërvajtëse, për zbatimin e procedurës administrative dhe qytetare, e që dhënia e së cilit do të kishte pasoja të dëmshme për vijim e procedurës;
- 5) Informacion i cili rrezikon të drejtat e pronësisë industriale apo intelektuale.

### **4.2. Dispozita tjera adekuate për përjashtimet**

Ligji për informacione të klasifikuara<sup>11</sup> (në tekstin e mëtejshëm: LK) dhe Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale<sup>12</sup> (në tekstin e mëtejshëm: LMDHP) në mënyrë të detajuar i përcaktojnë përjashtimet lidhur me mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe të dhënave personale.

<sup>9</sup> Shiko pika 7.1 të këtij Doracak

<sup>10</sup> Shiko neni 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut

<sup>11</sup> („Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 275/2019)

<sup>12</sup> („Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 42/2020)

Dispozita konkrete me të cilat përcaktohen më shumë detaje për esencën dhe për zbatimin e përjashtimeve të caktuara mund të gjenden në Ligjin për procedurë tatimore<sup>13</sup>, Ligjin për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>14</sup>, Ligjin për procedurë për kundërvajtje<sup>15</sup>, Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, Ligjin për procedurë kontestuese<sup>16</sup>, Ligjin për pronësi industriale<sup>17</sup> dhe ligj tjetër.

Kaptinë e posaçme për çasjen në informacione për mjedisin jetësor dhe për përkufizimet e përcaktuara në qasje deri tek ato është shtuar në Ligjin për mjedis jetësor (Kreu VII, nenet 51-58).

Qasja në informacione lidhur me të dhënat personale është përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.<sup>18</sup>

### **KUJDES:**

**Rrefuzimi i qasjes në informacione me karakter publik duhet të bazohet jo vetëm në dispozitën adekuate ligjore të nenit 6 paragrafi 1 i LQLIKP por edhe të dispozitës adekuate të ligjit të posaçm të cilin e përcakton përkufizimi i dhënë, pa dallim se rrefuzimi është i pjesërishëm apo i tërësishëm.**

Dispozitat e ligjit të posaçëm adekuat duhet të merren parasysh të jenë të pasqyruara në arsyetimin e vendimit për rrefuzimin e qasjes, bashkë me bazën ligjore në pajtueshmëri me LQLIKP.

Për shembull, gjatë rrefuzimit të qasjes në informacione të klasifikuara, përveç thirrjes në nenin 6, paragrafi 1, pika 1 e LQLIKP, organi duhet të theksojë edhe dispozitën adekuate të Ligjit për informacione të klasifikuara.

## **5. INTERESE TË MBROJTURA**

Lista e interesave të mbrojtur mundet lehtë të vërtetohet në bazë të dispozitave adekuate të LQLIKP si dhe standardeve ndërkombëtare. Dispozita e nenit 3, paragrafi 1 e Konventës për qasje në dokumente publike<sup>19</sup> në tekstin e mëtejshëm: **Konventa**) cakton 11 kategori të interesave që do të mundej të arsyetojnë qasje të kufizuar në dokumente<sup>20</sup>.

<sup>13</sup> („Gazeta zyrtare e RMV” nr. 13/06, 88/08, 159/08, 105/09, 133/09, 145/10, 171/10, 53/11, 39/12, 84/12, 187/13, 15/15, 97/15, 129/15, 154/15, 23/16 и 35/18 dhe „Gazeta zyrtare e RMV” nr. 275/19 dhe 290/20)

<sup>14</sup> („Gazeta zyrtare e RMV” nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe „Gazeta zyrtare e RMV” nr. 110/21)

<sup>15</sup> („Gazeta zyrtare e RMV” nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18)

<sup>16</sup> („Gazeta zyrtare e RMV” nr. 79/05, 110/08, 83/09, 116/10 dhe 124/15)

<sup>17</sup> („Gazeta zyrtare e RMV” nr. 21/09, 24/11, 12/14, 41/14, 152/15, 53/16 dhe 83/18 dhe „Gazeta zyrtare e RMV” nr. 31/20)

<sup>18</sup> Shiko neni 19 i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

<sup>19</sup> CETS 205 – Access to Official Documents, 18.VI.2009

<sup>20</sup> Republika e Maqedonisë së Veriut ka nënshkruar Konventën në vitin 2009. Hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2020 pasi u ratifikua në dhjetë vende. Teksti zyrtar mund të gjendet në: <https://rm.coe.int/1680084826>

Pjesa më e madhe e tyre janë theksuar pothuajse në të gjitha ligjet kombëtare për qasje në informacione. Interese të zakonshme të mbrojtura janë:

- Siguria kombëtare, mbrojtja dhe marrëdhëniet ndërkombëtare;
- Rendi publik dhe paqja;
- Privatësia personale;
- Sekrete tregtare;
- Integriteti i mbikqyrjes inspektuese të zbatuar nga organet publike;
- Hetimet penale.

Legjislativa e Maqedonisë mbulon pjesën më të madhe të interesave të mbrojtura të lartpërmendura. Për shembull, në pajtueshmëri me LQLIKP, informacionet e klasifikuara janë të theksuara si përjashtim i qasjes së lirë.<sup>21</sup> Në pajtueshmëri me Ligjin për informacionet e klasifikuara, qëllimi i klasifikimit të të dhënave është që të mbrohet siguria dhe mbrojtja e shtetit, integriteti i tij teritorial dhe sovraniteti, rendi kushtetues, interesi publik dhe liritë e ë drejtat e njeriut.<sup>22</sup> Kjo është në pajtueshmëri me interesat e theksuara në Konventë, gjegjësisht, siguria kombëtare, mbrojtja dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.<sup>23</sup>

Në LQLIKP si interes i mbrojtur janë theksuar edhe të dhënat personale,<sup>24</sup> që korrespond me interesin e ngjajshëm të mbrojtur me Konventë.<sup>25</sup>

Sikur LQLIKP ashtu edhe Konventa përcaktojnë mbrojtjen e informacioneve të fituara apo të hasura për shkak të hetimit, procedurës ndëshkuese apo për kundërvajtje dhe për shkak të zbatimit të procedurës administrative dhe qytetare. Në Konventë këto interese janë theksuara në dy kategori të posaçme. Ato janë të sqaruara si:

- 1) Interes për "parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e aktiviteteve kriminale";
- 2) Interes për "barazi për palët në procesin gjyqësor dhe në zbatimin efektiv të të drejtave".

Interese të caktuara të theksuara në Konventë, me LQLIKP janë të mbrojtura në vëllim më të ngushtë. Për shembull, në Konventë theksohen ineterese komerciale apo ekonomike, përdersa me LQLIKP përjashtimi ka të bëjë vetëm me pronësinë industriale, gjegjësisht intelektuale, duke mos i kyçur edhe interesat tjera ekonomike.

## 6. PËRCAKTIMI I INTERESIT TË MBROJTUR

Kjo pjesë e testit të dëmit ka për qëllim të përcaktojë se a ekziston interesi i mbrojtur në informacionin e kërkuar dhe a ka të bëjë intereso me dispozitën adekuate të nenit 6, paragrafi 1 të LQLIKP

<sup>21</sup> Shiko neni 6, paragrafi, pika 1 i LQLIKP.

<sup>22</sup> Shiko neni 6, paragrafi 2, nga Ligji për informacione të klasifikuara.

<sup>23</sup> Shiko neni 3, paragrafi 1, pika "a" nga Konventa.

<sup>24</sup> Shiko neni 6, paragrafi 2, pika 1 nga LQLIKP.

<sup>25</sup> Shiko neni 3, paragrafi 1, pika "f" nga Konventa

Gjatë përcaktimit të interesit publik, poseduesi është i obliguar, në secilin rast individual, ta përcaktojë mundësinë se sigurimi i qasjes në informacionin e kërkuar do të ishte shkelje serioze e interesit të mbrojtur me përjashtimet e nenit 6 paragrafi 1 të LQLIKP. Vetë përjashtimi në mënyrë implicite apo eksplicite përmban interesin publik për mbrojtje të informacionit të kërkuar. Me fjalë tjera, organi publik patjetër duhet ta arsyetojë mundësinë se interesi i mbrojtur do të jetë i shkelur, gjegjësisht se është me interes publik që të mbrohen informacionet nga publiku.

Nga ana tjetër, fakti se informacioni i kërkuar përket në njërin e përjashtimeve ligjore nuk do të thotë sërë në mënyrë automatike interesi i mbrojtur seriozisht do të jetë i shkelur me sigurimin e qasjes në informacion, gjegjësisht dëmi patjetër duhet të jetë i përcaktuar në mënyrë konkrete dhe precize.

**Me fjalë të tjera, poseduesi i informacionit nuk duhet të spekulojë, të supozojë dhe/ose të përdorë hiperbolë (ekzagjerim) të shfaqjes së dëmit të mundshëm gjatë publikimit të informacionit, por të japë një identifikim të qartë dhe të paqartë të arsyeve pse publikimi i informacionit të caktuar do të çojë në pasojë të dëmshme për interesat e mbrojtura.**

Në pjesën tjetër janë dhënë shembuj të caktuar të cilat demonstrojnë se si përcaktohet dëmi potencial nga sigurimi i informacionit me karakter publik:

### **6.1. Informacione të klasifikuara**

Nëse personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione mendon se informacioni i kërkuar ka të bëjë me sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, duhet të kontrollojë se a është e klasifikuar në pajtueshmëri me Ligjin për informacione të klasifikuara. Nëse informacioni nuk është i klasifikuar dhe i theksuar formalisht në pajtueshmëri me dispozitat e LIK, atëherë nuk ka dëm që të publikohet.

Kjo konkluzë është e vlefshme edhe nëse personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione mendon se me publikimin e informacioneve të kërkuara do të rrezikoheshin interesat e sigurisë kombëtare, mbrojtja dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo është kështu për shkak se me Ligjin në informacione të klasifikuara, si dhe kriteret, masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara. Vetëm oficerët të cilët janë të autorizuar në pajtueshmëri me LIK dhe të cilët kanë qasje në informacione të klasifikuara mund të bëjnë vlerësime për dëmin potencial gjatë publikimit të informacioneve të klasifikuara.

Në pajtueshmëri me të lartëpërmendurën, nëse dokumenti i kërkuar është i klasifikuar në pajtueshmëri me LIK, personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione nuk mundet në mënyrë unilaterale të vendosë të mundësojë qasje në informacione. Në mënyrë plotësuese, për shkak të qasjes së kufizuar në dokumente të klasifikuara (në pajtueshmëri me parimin “është e nevojshme të dihet”), personi zyrtar shpesh herë nuk ka qasje në përmbajtjen e tyre dhe prej këtu nuk do të mundet ta vlerësojë dëmin potencial nga publikimi i tyre.

Rrjedhimisht, secili vlerësim i sërishëm i dëmit mund të zbatohet vetëm nga ana e personit zyrtar (oficer) i cili ka autorizim adekuat për klasifikim, gjegjësisht deklasifikimin e informacioneve.

#### **KUJDES:**

**Ekzistojnë raste kur informacionet klasifikohen në pajtueshmëri me ligj të posaçëm, ndryshe nga LIK. Për shembull, Ligji për Bankën popullore të RMV përcakton kategorizim**

**të posaçëm<sup>26</sup> të informacioneve lidhur me bankat ndjeshmëria e të cilave vlerësohet në pajtueshmëri me kriteret e posaçme për rrezikun potencial në rast të publikimit.**

## 6.2. Të dhëna personale

E dhënë personale është secili informacion i cili ka të bëjë me personin fizik të identifikuar apo person fizik i cili mund të identifikohet. Kjo do të thotë se vetëm personi fizik mund të jetë i goditur nga publikimi i informacionit konkret me karakter publik. Në mënyrë adekuate përjashtimi i cili ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale nuk mund të zbatohet në raste kur informacioni i kërkuar ka të bëjë me entin publik, subjektin afarist apo person tjetër juridik siç është shoqata apo fondacioni.

Nëse është përfshirë person juridik, e jo person fizik, atëherë nuk ka dëm për interesin e mbrojtur. Nëse personi fizik me të cilin ka lidhje informacioni nuk është më gjallë, nuk ka asnjë dëm që do t'i ndodhte interesave të tij të mbrojtura dhe zakonisht sigurohet qasja në informacione të tilla.

### **KUJDES:**

**Nëse informacioni i kërkuar ka të bëjë me përdorimin e mjeteve publike, të dhëna personale të caktuara të cilat janë pjesë e informacionit të kërkuar nuk llogariten për informacione publikimi të cilave do të ishte shkelje e të dhënave personale.**

***Shembull: Informacione në lidhje me pagën bruto të një nëpunësi administrativ ose një zyrtari të emëruar në një ndërmarrje publike, një bursë e dhënë nga një organ shtetëror për studentët e suksesshëm, shitja e pronës shtetërore nëpërmjet një organi shtetëror një kompanie private, persona të cilët Qeveria i ka angazhuar me kontratë si honorarë etj.***

## 6.3. Informacione lidhur me besueshmërinë e procedurave tatimore

Ky përjashtim<sup>27</sup> është i zbatueshëm për procedurat e përcaktuara në përputhje me Ligjin për Procedurën Tatimore<sup>28</sup>. Kjo do të thotë se ky përjashtim nuk është i zbatueshëm për asnjë procedurë tjetër administrative të kryer sipas një ligji tjetër. Kështu ndodh edhe kur ka ngjashmëri në mënyrën e funksionimit të organeve, siç është rasti me inspektimet.

Gjithashtu, ky përjashtim nuk zbatohet për të gjitha procedurat që përfshijnë organet tatimore. Për shembull, procedurat e emërimit të personelit në organet tatimore, procedurat e kryera të prokurimit publik në këto organe, udhëzimet për mënyrën e zhvillimit të procedurës tatimore, etj. nuk përfshihen nga ky përjashtim.

Prandaj, nëse personi zyrtar përi ndërmjetësim me informacione konsideron se ka dëm potencial nga p.sh. publikimi i parakohshëm i informatave lidhur me konsultimin për përgatitjen e draft-rregullores për kryerjen e procedurës së caktuar tatimore, personi nuk mund t'i referohet përjashtimit nga neni 6 paragrafi 1 pika 3) të LQLIKP.

## 6.4. Informacione të fituara apo të përpiluara për hetim, procedurë penale apo për kundërvajtje

Ky përjashtim vlen për të gjitha dokumentet e përfshira në objektin e një hetimi formal, procedurë penale ose kundërvajtëse. Sidoqoftë, nuk mbulon dokumentet që nuk janë pjesë

<sup>26</sup> Shiko neni 34, neni 57 dhe neni 74 nga Ligji për BPRMV

<sup>27</sup> Shiko neni 6, paragrafi 1, pika 3 e LQLIKP.

<sup>28</sup> („Gazeta zyrtare e RMV” nr. 13/06, 88/08, 159/08, 105/09, 133/09, 145/10, 171/10, 53/11, 39/12, 84/12, 187/13, 15/15, 97/15, 129/15, 154/15, 23/16 dhe 35/18 dhe „Gazeta zyrtare e RMV” nr. 275/19 dhe 290/20)

e procedurës. Zakonisht lëndët për procedura të tilla mbahen në Prokurorinë Publike ose në polici, përkatësisht në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Qëllimi i mbrojtjes tek ky përjashtim është që të parandalohet shkatërimi apo në ndonjë mënyrë të komprometimit të informacioneve të cilat do të mund të grumbulloheshin si dëshmi kundër një të dyshuari të caktuar. Interesi i mbrojtur synon garantimin e sigurisë dhe integritetit të procedurës dhe drejtësisë për veprat e identifikuara penale.

Mbrojtja që rrjedh nga ky përjashtim zgjat vetëm derisa çështja të përfundojë me një vendim përfundimtar në gjykatë ose derisa procedura të përfundojë. Rrjedhimisht, që nga ai moment, nuk ka asnjë të keqe nga publikimi i informacionit.

Megjithatë, ky përjashtim nuk përfshin dokumente të tjera që disponon, për shembull, Ministria e Punëve të Brendshme, siç është buxheti, raportet, statistikat, etj. as nuk përfshin të gjitha të dhënat në çështjen penale si p.sh., emrin e prokurorit publik që punon në një hetim penal specifik, datën e kallëzimit penal, etj.

#### **KUJDES:**

**Tek qasja e lirë në informacione me karakter publik, interesi publik është neutral, ashtu që ekzistimin e tij mundemi ta vërtetojmë edhe nëpërmjet përkufizimit të qasjes në informacionin e kërkuar.**

**Me fjalë tjera, gjatë zbatimit të testit të dëmit mundet të përcaktohet se interesi publik qëndron në nevojën që të përkufizohet e drejta e qasjes në informacionin e kërkuar, për arsye është me interes publik që të mos publikohet informacioni, por duhet në mënyrë precize të detektohet se cilat pasoja do të ndodhnin pasi të publikohet informacioni**

### **6.5. Informacioni i marrë ose i përpiluar për zhvillimin e një procedure administrative**

Këto janë informacione lidhur me procedura të përcaktuara me Ligjin për Procedurë të Përgjithshme Administrative dhe Ligjin për Konteste Administrative.

Në rast të refuzimit të qasjes në përputhje me këtë përjashtim, poseduesi duhet të përcaktojë ekzistimin e një probabiliteti që publikimi i informacionit të kërkuar do të rrezikonte integritetin e procedurës, përkatësisht do të ndërlikonte punën e institucionit që zhvillon procedurën. Rrjedhimisht, poseduesi mund të kufizojë aksesin në informacionin e kërkuar nëse duke e publikuar atë:

- do të pengojë zhvillimi efikas, i pavarur dhe i paanshëm i procedurës administrative ose mosmarrëveshjes administrative, ekzekutimi i një vendimi ose sanksioni gjyqësor.
- puna e organeve që kryejnë mbikëqyrje administrative dhe inspektuese, pra kontrolli i ligjshmërisë do të vështirësohej.

Kështu ndodh me të gjitha procedurat aktuale administrative për dhënien e dokumenteve si certifikata të lindjes, diploma, patentë shoferi, patenta, leje ndërtimi, ekstrakte nga plani i detajuar urban (PDU) e shumë të tjera.



Në raste të tjera, organet publike kanë kontroll mbi, për shembull, formën e inspektimeve. Në këto raste, djënia e qasjes së parakohshme në informacion mund të dëmtojë vërtetimin e duhur të fakteve dhe të përfitojë subjektin që inspektohet.

### **KUJDES:**

**Në të gjitha rastet nënkuptohet se pasi të mbarojë procedura dhe do të sjellet vendim përfundimtar, informacionet e krijuara dhe të grumbulla gjatë procedurës do të jenë të kapshme. Kjo do të thotë se nuk do të ketë dëm nga publikimi i tyre.**

## **6.6. Informacioni i marrë ose i përpiluar për zbatimin e procedurave qytetare**

Këto janë informacione lidhur me konteste vijuese qytetaro – juridike. Nëse mund të sigurohet qasje në informacione mund të sigurohet nga ana e gjyqit apo organit publik që është palë në procedurë, veprimi i tillë e hap derën për palën e kundërt në kontest që të kërkojë qasje në dokumente para se të jenë të prezantuara të njejtat para gjyqit si dëshmi. Që këtu, parimi i barazisë të palëve do të jetë i shkatërruar dhe mund të ketë pasoja negative mbi respektimin e parimit për gjykim të drejtë.

Në raste të tilla, dokumentet (informacionet) e kërkuara jepen me propozim në gjykatë, e cila duhet t'i sigurojë ato sipas detyrës zyrtare. Informacionet e tilla nuk mund t'i nënshtrohet një kërkesë për qasje në informacione me karakter publik, sepse ato janë kryesisht dokumente për një procedurë specifike, në të cilën vetëm palët në procedurë kanë një interes ligjor, të cilin e fitojnë në rastin në fjalë.

Në çdo rast, ky përjashtim nuk ka të bëjë me informacionet rreth situatës së lëndës apo për çështjen kur dhe ku do të zhvillohet senaca e ardhshme publike në gjyq. Këto informacione gjithmonë duhet të jenë të kapshme publikisht dhe të publikohen pas kërkesës së parashtruar.

## **6.7. Informacioni i cili i rrezikon të drejtat e pronësisë intelektuale**

Format e ndryshme të pronësisë intelektuale dhe industriale përcaktohen me Ligjin për Pronësinë Industriale (LIP)<sup>29</sup> dhe Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta<sup>30</sup> (LDADP). Ky përjashtim përfshin patentën, dizajnin industrial, markën tregtare, emërtimin e origjinës, treguesin gjeografik, të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura.

Përkufizimi i qasjes në informacione me karakter publik në pajtueshmëri me këtë përjashtim mund të zbatohet vetëm nëse:

- informacioni i kërkuar është pjesë përbërëse e dokumentacionit për regjistrimin/certifikimin e një lloji të caktuar pronësie industriale, në përputhje me dispozitat e LIP ose
- pas një kufizimi (ndalimi) të dhënë shprehimisht, në përputhje me LDADP.

<sup>29</sup> ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 21/09, 24/11, 12/14, 41/14, 152/15, 53/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta zyrtare e RMV" nr. 31/20)

<sup>30</sup> („Gazeta zyrtare e RM” nr. 115/10, 140/10, 51/11, 147/13, 154/15 dhe 27/16)



## KUJDES:

**Në rastin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, edhe nëse poseduesi vendos se publikimi i informacionit do të dëmtojte interesat materiale të autorit, poseduesi i informacionit duhet që përmes testit të dëmshmërisë të shterojë çdo mundësi për të siguruar qasje në informacionin e kërkuar, duke mundësuar qasje të pjesërishme.**

## 7. KUR PËRCAKTOHET DËMI?

Vlerësimi i dëmit mund të bëhet:

- paraprakisht;
- kur të dorëzohet kërkesa.

### 7.1. Vlerësimi i cili bëhet para se të dorëzohet kërkesa

Në disa raste, legjislacioni parashikon që paraprakisht duhet të bëhet një vlerësim nëse dhënia e informacionit mund të dëmtojë interesin e mbrojtur.

Një shembull i kësaj është përjashtimi për **informacionet e klasifikuara**. Në këto raste, dokumentet që përmbajnë informacione të ndjeshme paraklasifikohen nga zyrtarët e autorizuar në përputhje me procedurën e përcaktuar në detaje nga ligji përkatës (LIK). Ky vlerësim i dëmshmërisë është i zbatueshëm edhe për **mbrojtjen e pronësisë industriale**, ku ajo është e regjistruar/certifikuar sipas një procedure të veçantë.

Në këto raste, vlerësimi i dëmit bëhet në momentin e përfundimit të procedurës në fjalë (klasifikimi, regjistrimi i patentave), që zakonisht është përpara kërkesës për qasje. Në këto raste specifike tashmë ka një indikacion se publikimi i informacionit mund të dëmtojë interesin e mbrojtur.

### 7.2. Vlerësimi i cili bëhet pasi të dorëzohet kërkesa

Në një grup tjetër rastesh, vlerësimi nëse mundësimi i qasjes në informacione të caktuara do të ishte i dëmshëm për interesin e mbrojtur kryhet nga poseduesi i informacionit, me një kërkesë specifike. Ky është rasti me shumicën e përjashtimeve të parapara me nenin 6 të LQLKP.

**Për shembull, nëse do të ketë dëm për një individ (person fizik) nëse një dokument publikohet duhet të vlerësohet kur do të dorëzohet kërkesa për informacion. Kështu ndodh edhe me informacionet e marra ose të mbledhura për procedurat hetimore, penale ose kundërvajtëse dhe për zhvillimin e procedimeve administrative dhe gjyqësore.**

Në këto raste, vlerësimin e kryen personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione. Mund të konsultohet me persona tjerë zyrtarë në organ të cilët çdo ditë punojnë me informacionet dhe e kuptojnë mirë natyrën e tyre dhe interesat potenciale mbi të cilat mund të shkaktohet dëmi.<sup>31</sup>

Megjithatë, sjellja e vendimit përfundimtar është obligim i personit zyrtar për ndërmjetësim me informacione.

<sup>31</sup> Shiko pika 3 e këtij Doracak

## 8. KOHËZGJATJA E MBROJTJES SË INFORMACIONEVE

Kohëzgjatja e mbrojtjes së informacioneve është formë konkrete e zbatimit të testit të dëmit.

Në një shoqëri demokratike nuk mund të ketë përjashtime të përvetshme për qasjen në informacione sepse konsiderohet se rreziku i dëmtimit të interesave të mbrojtura mund të ekzistojë vetëm për një periudhë të kufizuar kohore. Kjo është e përcaktuar pjesërisht në nenin 6 paragrafi 2 të LQLIKP-së, sipas të cilit informacionet me karakter publik, edhe kur i nënshtrohen përjashtimit nga LQLIKP, "bëhen të disponueshme kur pushojnë arsyet e padisponueshmërisë së tyre".

Kohëzgjatja e përjashtimeve pasqyron supozimin se pas një periudhe të caktuar kohore nuk do të ketë më rrezik për dëmtimin e interesit të mbrojtur. Pas këtij intervali kohor, dokumenti, përkatësisht informacioni mund të publikohet nëse i njejti kërkohet.

Me fjalë të tjera, ndjeshmëria e informacionit të mbrojtur zvogëlohet me kalimin e kohës dhe në një moment mbrojtja nuk është më e zbatueshme. Kur vjen ky moment ose siç thotë ligji, kur arsyet e mosdisponueshmërisë pushojnë, atëherë informacioni bëhet i disponueshëm dhe personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione duhet të sigurojë qasje në të.

### 8.1. Përcaktimi i periudhës së mbrojtjes

Periudha e mbrojtjes së informacioneve mund të përcaktohet:

- me dispozitë të qartë në ligj,
- me jetëgjatësinë e lëndës së të dhënave;
- në varësi të rrethanave konkrete që përjashtojnë zbatueshmërinë e interesit të mbrojtur.

Në disa përjashtime, periudha e mbrojtjes përcaktohet me ligj. Në të tjerat, periudha nuk është përcaktuar dhe këtu testi i dëmit zbatohet kur personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione duhet të vlerësojë nëse do të ketë dëme nga publikimi i informacionit të kërkuar.

#### 1) Përkufizimi kohor për mbrojtjen i përcaktuar me ligj:

**Për shembull, edhe për informacionet më të ndjeshme që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë kombëtare dhe të mbrojtjes, Ligji për Informacionin e Klasifikuar përcakton afate kohore për mbrojtjen e tyre.**

#### 2) Periudha e mbrojtjes e përcaktuar nga natyra:

**Për shembull, kur bëhet fjalë për të dhëna personale, mbrojtja vlen deri sa të jetë gjallë personi fizik dhe e njëjta nuk zbatohet pas vdekjes së personit.**

#### 3) Periudha e mbrojtjes e përcaktuar nga rrethanat konkrete:

**Nëse patenta ka skaduar ose është tërhequr nga një autoritet publik kompetent ose një gjykatë, atëherë përjashtimi i pronësisë intelektuale nuk zbatohet më.**

## 9. PROPORCIONALITETI NË ZBATIMIN E PËRJASHTIMEVE

Parimi i proporcionalitetit është një parim themelor që bazohet në nivelin kushtetues. Sipas Kushtetutës së RMV-së, disa të drejta dhe liri të njeriut mund të kufizohen me ligj, në rrethana të jashtëzakonshme, kur kufizimi është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë e Republikës, për të kryer procedura penale ose për të mbrojtur shëndetin e njeriut, për të mbrojtur interesin publik etj.

Për arsye se qasja e lirë në informacione, ndër të tjera, ushtrohet përmes një procedure të veçantë administrative, është e rëndësishme të theksohet se vetë Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 6, përcakton se:

*„(1) Organi publik gjatë zhvillimit të procedurës administrative duhet t'i mundësojë palës të ushtrojë dhe mbrojë të drejtat dhe interesat e saj ligjore, nëse ato nuk janë në dëm të të drejtave dhe interesave juridike të palëve të tjera ose të palëve të treta dhe nuk janë në dëm të interesit publik të përcaktuar me ligj.*

*(2) Kur palëve në procedurë u ngarkohen detyrime, organi publik është i detyruar të zbatojë ato veprime administrative që janë më të favorshme për palët, nëse veprimet e tilla janë të mjaftueshme për arritjen e qëllimit të përcaktuar me ligj.“*

Nga e lartpërmendura del se parimi i proporcionalitetit mund të identifikohet nëpërmjet tre elementeve:

1. Legjitimiteti i masës, gjegjësisht qëllimi që duhet arritur me kufizimin e të drejtave (me fjalë të tjera nëse masa është e paraparë me ligj).
2. Domosdoshmëria e masës për arritjen e qëllimit që duhet të arrihet me kufizimin e së drejtës (me fjalë të tjera nëse masa i përgjigjet arritjes së një qëllimi legjitim, gjegjësisht nëse ka lidhje ndërmjet masës dhe mbrojtjes së një qëllimi legjitim mund të vendoset)
3. Përcaktimi i proporcionalitetit në një kuptim më të ngushtë, i cili manifestohet duke gjetur një ekuilibër midis një mase që kufizon të drejtat e garantuara për të arritur një qëllim të caktuar dhe shkallës së lejuar të ndërhyrjes në të drejtat e garantuara (me fjalë të tjera, nëse masa është e nevojshme në një shoqëri demokratike).

Si rregull, nëse përgjigja për ndonjërin nga këto pyetje është negative, kufizimi i të drejtave nuk konsiderohet i justifikuar, pra nuk është në përpjesëtim me qëllimin.

Prandaj, zbatimi i parimit të proporcionalitetit në qasjen e lirë kërkon që poseduesi i informacionit të zbatojë me kujdes dhe saktësi përjashtimet nga LQLIKP. Kjo do të thotë që personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione duhet të refuzojë qasjen vetëm në atë pjesë të informacionit që është e nevojshme për të mbrojtur interesin në përputhje me nenin 6 paragrafi 1 të LQLIKP.

Në përputhje me standardet evropiane dhe legjislacionin kombëtar, proporcionaliteti zbatohet në mënyrat e mëposhtme:

- Interpretim i ngushtë i përjashtimeve;
- Përcaktimi i formës së qasjes;
- Mundëson qasje të pjesërishme.

Zbatimi i secilës prej këtyre elementeve është demonstruar më poshtë.

### 9.1. Interpretim i ngushtë i përjashtimeve

E drejta për qasje në informacione me karakter publik është një e drejtë themelore e njeriut e njohur në nivelin kushtetues dhe ligjor. Kjo specifikë shpie në faktin se çdo përjashtim i përmendur në nenin 6 paragrafi 1 i LQLIKP duhet të zbatohet si përjashtim nga parimi i hapjes dhe transparencës.

Rrjedhimisht, kur vepron sipas një kërkesë për qasje të lirë, poseduesi nuk duhet të tejkalojë kufijtë ligjorë të përjashtimeve në Nenin 6 paragrafi 1 të LQLIKP -së dhe duhet të jetë sa më kufizues në zbatimin e tyre.

Përcaktimi i interesit të mbrojtur dhe rëndësia e tij me përjashtimet e përmendura në nenin 6<sup>32</sup> shpjegon se si zbatohet parimi i "interpretimit të ngushtë të përjashtimeve".

### 9.2. Përcaktimi i formës së qasjes

Sipas LQLIKP, poseduesi i informacionit mund të ofrojë informacionin e kërkuar në një formë të ndryshme nga ajo e zgjedhur<sup>33</sup> nga kërkuesi. Në këto raste, personi zyrtar është i detyruar të japë shpjegim për këtë mënyrë të veprimit. Ky shpjegim duhet theksuar në vendimin me të cilin poseduesi vepron sipas kërkesës.

**Për shembull, prona intelektuale, duke përfshirë të drejtën e autorit, mbrohet me nenin 6 të LQLIKP. Megjithatë, nëse një dokument me të drejtë autori përgatitet nga një kompani private në emër dhe/ose në kurriz të një autoriteti publik, atëherë qasja mund të sigurohet në formën e një inspektimi të dokumentit në ambientet e organit ose duke siguruar një kopje të shtypur në vend të një kopje dixhitale.**

**Ky veprim konsiderohet si një praktikë jashtëzakonisht pozitive, sepse në të njëjtën kohë siguron qasje në informacion, dhe mbron interesat e bartësit të së drejtës së pronësisë intelektuale.**

### 9.3. Mundësimi i qasjes së pjesërishme

Sigurimi i qasjes së pjesërishme është paraparë me nenin 20, nenin 22 dhe nenin 25 të LQLIKP-së. Koncepti i qasjes së pjesërishme kërkon që përjashtimet nga qasja në informacione të zbatohen vetëm për atë pjesë të informacionit që lidhet me interesin e mbrojtur.

Prandaj, poseduesi i informacionit duhet të lejojë qasje vetëm në pjesën e informacionit që është jashtë fushës së përjashtimit. Nga ana tjetër, ai duhet të refuzojë qasjen në disa nga informacionet që prekin interesin e mbrojtur. Veprimi i tillë duhet të shpjegohet hollësisht në vendimin me të cilin poseduesi vepron sipas kërkesës.

<sup>32</sup> Shiko pika 6 e këtij Doracak

<sup>33</sup> Shiko nenin 21 paragrafi 2 të LQLIKP

**Një shembull tipik i aplikimit të një qasjeje të pjesërishme janë të dhënat personale. Në ato raste zakonisht nuk është problem të errësohen (anonimizohen) ose të fshihen të dhënat personale dhe të sigurohet qasje në informacione të tjera, për shembull, raport, letër, vendim zyrtar, marrëveshje, etj.**

## **10. BALANCIMI I DËMIT KUNDREJT INTERESIT PUBLIK NGA PUBLIKIMI I INFORMACIONIT**

Pasi personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione të konstatojë se interesi i mbrojtur është i rrezikuar dhe se interesi përputhet me një ose më shumë nga përjashtimet në nenin 6, paragrafi 1 i LQLIKP-së, hapi tjetër është zbatimi i parimit të proporcionalitetit siç është përcaktuar më lart. Nëse qasja e pjesërishme nuk është e mundur, atëherë personi zyrtar duhet të përdorë balancimin e interesave kundërshtuese. Pastaj, bazuar në aktin e balancimit, personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione do të vendosë nëse do të rrefuzojë ose do të mundësojë qasje në informacione.

Në këtë pikë, personi zyrtar tashmë ka konstatuar se dhënia e informacionit të kërkuar do të mbrojë interesin e mbrojtur. Tani duhet të përcaktohet nëse ekziston një interes publik mbizotërues për publikimin e informacionit të kërkuar.

### **10.1. Interes publik mbizotërues për publikimin e informacionit**

LQLIKP përcakton se ekziston një supozim i interesit publik në një numër rastesh<sup>34</sup> të theksuara. Përkufizimi i interesit publik në LQLIKP nuk është shterues, por vetëm tregues. Ligjvënësi i Maqedonisë nuk ka identifikuar arsyet për interesin publik mbizotërues, por praktika krahasuese dhe standardet ndërkombëtare kanë zhvilluar një sërë argumentesh në favor të qasjes së lirë në informacione me karakter publik.

Poseduesi duhet të përcaktojë nëse në një rast të caktuar, sigurimi i qasjes në informacionin e kërkuar do të kontribuojë në interesin publik në arritjen e vlerave thelbësore të organeve publike, të tilla si **qeverisja e mirë, ligjshmëria, llogaridhënia, integriteti, efikasiteti i rendit shoqëror dhe parimet specifike të efektivitetit, menaxhimin e mirë financiar dhe disponimin me përgjegjësi të fondeve publike, barazinë dhe të ngjashme.**

Me fjalë të tjera, poseduesi duhet të përcaktojë nëse zbulimi i informacionit do të kontribuonte në mundësinë e të kuptuarit të debatit publik, pyetjes ose kuptimit të pasojave të vendimeve të organit publik, përgjegjësive të organit publik në kryerjen e funksioneve të tij, përgjegjësive për posedimin e fondeve publike, sigurinë publike, shëndetin ose mbrojtjen e mjedisit.

#### **KUJDES:**

**Interesi publik mbizotërues përcaktohet vetëm në rastet kur informacioni i kërkuar bie nën mbrojtjen e përjashtimeve dhe kur do të dëmtohej interesi i mbrojtur gjatë publikimit të informacionit. Përndryshe, nuk ka nevojë të vlerësohet interesi publik nëse poseduesi i informacionit nuk e ka konstatuar dëmin ose nëse nuk ka interes që mbrohet me përjashtimet e cekura në nenin 6, paragrafi 1 i LQLIKP. Nëse nuk ka dëme, informacioni thjesht duhet të publikohet.**

<sup>34</sup> Neni 3, pika 7 e LQLIKP

## 10.2. Rrethanat e interesit publik

Në LQLIKP janë përshkruar shtatë raste të publikimit potencial të informacioneve për shkak të interesit publik mbizotërues. Interesi publik ekziston kur informacioni:

- 1) Do të zbulojë keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe sjelljes korruptive;
- 2) Do të zbulojë fitim dhe shpenzim të paligjshëm të mjeteve nga buxheti;
- 3) Do të zbulojë konflikt të mundshëm të interesave;
- 4) Do të parandalojnë ose zbulojnë kërcënime serioze për shëndetin dhe jetën e njerëzve;
- 5) Do të parandalon ose zbulon rrezikimin e mjedisit;
- 6) Do të ndihmojë për të kuptuar çështjen për të cilën krijohet një politikë publike ose zhvillohet një debat parlamentar;
- 7) Do të mundësojë trajtim të barabartë të çdo qytetari në përputhje me ligjet.

Në këto raste, personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione mund të vlerësojë se mbrojtja ligjore e përjashtimeve, ndonëse ekziston, është më i vogël se interesi publik për zbulimin e informacionit dhe më pas të sigurojë qasje në informacion.

## 10.3. Qëllimet e publikimit me interes publik

Shtatë rastet e interesit publik (kategoritë) të listuara në LQLIKP shërbejnë për qëllimet e mëposhtme të interesit publik:

- Kontributi në rritjen e integritetit të organeve publike dhe shpenzimit ligjor të parasë publike (kategoritë 1 - 3);
- Sigurimi i mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit (kategoritë 4 - 5);
- Mundësimi i pëlqimit të informuar dhe pjesëmarrjes qytetare (kategoria 6);
- Mundësimi i trajtimit të barabartë të qytetarëve nga organet publike (kategoria 7).

Këto qëllime duhet të merren parasysh kur personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione e zbaton nenin 6, paragrafi 3 të LQLIKP.

## 11. VENDIM PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK

Me rastin e veprimit të kërkesës për qasje të lirë, poseduesi i informacionit është i detyruar të përgatisë akt administrativ - Vendim. Ligji e pasqyron këtë detyrë në nenin 20, paragrafi 1 i LQLIKP-së, sipas të cilit "nëse poseduesi i informacionit i përgjigjet pozitivisht kërkesës ose nëse e refuzon pjesërisht ose tërësisht kërkesën, për këtë duhet të sjellë vendim".

Rregulloret përkatëse ligjore, si dhe praktika administrative dhe gjyqësore theksojnë rëndësinë kyçe të shpjegimit në aktin administrativ, sepse i mundëson palës të njihet me argumentet e përdorura nga organi publik në vendimmarrje, por edhe të mbrojtë të drejtat e saj dhe të përpiqet të hedh poshtë pretendimet e vendimit.

Nëse vendimi nuk ka shpjegim ose është i tillë që sipas përmbajtjes së tij nuk paraqet shpjegim të përshtatshëm (p.sh. reduktohet në formulimin: "poseduesi, pas kryerjes së testit të dëmit, konstaton se kërkesa e kërkuarit nuk mund të pranohet", etj.), është në kundërshtim me normat e përcaktuara qartë të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjegjësisht, në pajtueshmëri me nenin 88 paragrafi 4 të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative:

*"Arsyetimi duhet të jetë i kuptueshëm dhe duhet të përmbajë: një deklaratë të shkurtër të kërkesës së palës, nëse ka, faktet e vërtetuara sipas të cilave është nxjerrë akti administrativ, rregulloret ligjore dhe arsyet pse, në bazë të fakteve të vërtetuara, u miratua akti administrativ, arsyet se përse nuk u pranuan disa prej kërkesave, pretendimeve apo propozimeve të palëve, si dhe arsyet pse nuk u morën parasysh disa nga deklaratimet e bëra gjatë procedurës. Në rastin e një akti administrativ të miratuar sipas gjykimit të tij, arsyet kryesore pse e drejta për të vendosur sipas gjykimit të tij janë zbatuar në të njëjtën mënyrë si në aktin administrativ..."*

Me fjalë të tjera, nëse vendimi nuk përmban arsyetimin e duhur, kërkuari i informacionit vendoset në pozitë të pabarabartë në raport me poseduesin dhe nuk mund të ushtrojë plotësisht të drejtat e tij të garantuara me kushtetutë.

#### **KUJDES:**

**Hapat në pikën 3 të këtij Doracaku duhet të arsyetohen në detaje në çdo vendim për të refuzuar ose për të siguruar qasje të plotë ose të pjesërishtme në informacionet e kërkuara. Në të kundërtën, Agjencia si organ i shkallës së dytë në procedurë ankimore mund ta anulojë vendimin si të kundërligjshëm për shkak të mosekzistencës apo sqarimit të pamjaftueshëm të vendimit të kontestuar.**

**Gjithashtu, në pajtim me nenin 8 paragrafi 3 të LQLIKP-së, personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione mban shënime të veçanta për kërkesat e pranuar për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Është jashtëzakonisht e rëndësishme në evidencë<sup>35</sup> që të dhënat të tregojnë arsyet për secilën kërkesë të refuzuar ose të hedhur poshtë. Kjo do të thotë që nëse një pretendim (ose një pjesë e tij) refuzohet për ndonjë arsye, një përmbledhje e testit të dëmit (i kryer për çdo pretendim të refuzuar) duhet të jetë pjesë përbërëse e procesverbalit, përndryshe ai do të konsiderohet i paplotë.**

<sup>35</sup> Evidenca më tutje inkorporohet në Raportin vjetor i cili dorëzohet në Agjenci, në pajtueshmëri me nenin 36 të LQLIKP

## SHEMBULL

### *Kërkesë:*

Informacioni që është përshkruar në biografinë e një funksionari publik apo të një nëpunësi shtetëror me pozitë të lartë apo person ekspert i emëruar nga Qeveria të zbatojë detyrë të rëndësishme.

### ***Hapi 1: A ekziston përjashtim relevant?***

Përjashtimi i zbatueshëm është paraparë me nenin 6, paragrafi 1, pika 2 të LQLIKP.

### ***Hapi 2: A ekziston interes i mbrojtur?***

Të gjitha informacionet në lidhje me personin janë të mbrojtura. Ligji nuk përjashton zyrtarisht një kategori të caktuar të dhënash nga përkufizimi i "të dhënave personale".

### ***Hapi 3: A ka dëm nga publikimi?***

Informacioni është vërtet i lidhur me një individ. Prandaj, dhënia e informacionit do të shkaktonte dëm sepse një person fizik zakonisht nuk dëshiron që të publikohet asnjë informacion në lidhje me të.

### ***Hapi 4: A ekziston interes publik më i madh?***

Nga ana tjetër, të dhënat që lidhen me profesionin/funksionin janë përgjithësisht më pak të mbrojtura. Profesionin/funksionin është pjesë e aspektit social të jetës si individ, jo e jetës private. Gjithashtu, në këtë rast, të dhënat përdoren për përzgjedhjen e një personi për të kryer një funksion publik, e cila paguhet nga fondet publike.

Pyetjet përkatëse janë:

- A është personi personazh publik (zyrtar, ekspert)?
- A ka lidhje informacioni i kërkuar me detyrën publike?
- A do të rrisë informacioni njohuritë për zbatimin e detyrës publike?

Në këtë rast, biografia zbulon kualifikimet. Përgjigja për të gjitha këto pyetje është "po". Prandaj, mund të konkludohet lehtë se publikimi i këtij informacioni do t'i shërbente interesave të mëposhtme në përkufizimin e "interetit publik" në përputhje me nenin 3 të LQLIKP:

- Kontributi në integritetin më të mirë të organeve dhe administratës publike dhe shpenzimin e disiplinuar të parasë publike (kategoritë 1 - 3);
- Mundësimi i përzgjedhjes dhe pjesëmarrjes së publikut në bazë të informacionit (kategoria 6);



### ***Hapi 5: Proporcionaliteti***

Interesi publik mbizotërues ka të bëjë me të dhënat e arsimit dhe kualifikimeve. Megjithatë, ai nuk i referohet numrit të vetëm personal të identifikimit të qytetarit (NVAQ), detajeve të kontaktit (si adresa personale e postës elektronike, telefoni celular, adresa).

Prandaj, nëse në biografi ka të dhëna të tilla, ato duhet të anonimizohen.

### ***Hapi 6: Sjellja e vendimit të jepet apo të rrefuzohet dhënia e informacionit***

Informacioni në biografi duhet të jepet me përjashtim të NVAQ dhe të dhënat për kontakt.

Prandaj, duhet të sjellet Vendim për dhënien e qasjes së pjesërishme në informacionin e kërkuar.

### ***Hapi 7: Sqarimi i vendimit***

Vendimi duhet të përmbajë përshkrim të hapave të lartëpërmendura.

## DORACAK PËR ZBATIMIN E TESTIT TË DËMIT



Republika e Maqedonisë së Veriut



AGJENCIA E MBROJTJES TË SË  
DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË  
INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



Promovimi i transparencës  
dhe llogaridhënies  
në administratën publike